



---

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E MBROJTJES

MINISTRI

**Direktiva e Mbrojtjes 2020**

## **DIREKTIVA E MBROJTJES 2020**

### **Parathënie**

Në përfundim të vitit 2019, Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë (FARSH) kanë realizuar me sukses detyrat e tyre në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë, duke arritur rezultate të prekshme në të gjitha fushat e veprimtarisë së tyre. Ato tashmë janë më të konsoliduara si në pikëpamje të pajisjes, ashtu edhe të trajnimit.

Përmbushja e detyrimeve kushtetuese në fushën e mbrojtjes, përballimin e emergjencave civile dhe fatkeqësive natyrore, mbështetja e vazhdueshme ndaj komunitetit apo institucioneve të tjera të vendit, zgjerimi i hartës gjeografike të pjesëmarrjes në misionet ndërkombëtare, zbatimi i kontratave në fushën e modernizimit në infrastrukturë dhe pajisje, transparenca në menaxhimin e burimeve njerëzore dhe financiare, hapat e ndërmarra në reformimin e sistemit të arsimit dhe stërvitjes kanë rritur imazhin dhe besueshmërinë e FARSH-it në shoqëri, si dhe pritshmërinë dhe kërkesat ndaj tyre.

Mjedisi i sigurisë po ndryshon ndjeshëm natyrën, intensitetin, duke përfshirë gjithnjë e më shumë rreziqet e natyrës asimetrike, hibride dhe kibernetike. Miratimi i dokumentit të Rishikimit Strategjik të Mbrojtjes (RSM) së Republikës së Shqipërisë, ligjit “Për mbrojtjen civile” dhe një sërë dokumentesh të tjera në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë kanë adresuar më së miri këto rreziqe, duke iu përshtatur ndryshimeve të vazhdueshme të ambientit të sigurisë dhe si rrjedhojë përshtatjes të reagimit dhe kuptimit ndaj këtij ndryshimi.

Zbatimi i projekteve në fushën e modernizimit, të tilla si: fillimi i zbatimit të projektit të NATO-s për modernizimin e Bazës Ajrore Kuçovë, Sistemi i Integruar i Vëzhgimit të Hapësirës Ajrore të Republikës së Shqipërisë, përmirësimi i Sistemit të Integruar të Vëzhgimit të Hapësirës Detare, kompletimi me pajisje individuale të ushtarakut të Forcës Tokësore dhe pajisje speciale për Policinë Ushtarake, kompletimi i kompanisë EOD me mjete dhe sisteme moderne, pajisja me uniforma ceremoniale për Truprojën e Nderit dhe Orkestrën Frymore të FA-së, si dhe nënshkrimi i marrëveshjes me palën amerikane për pajisjen e FA-së me helikopterë Black Hawk kanë ndikuar pozitivisht në përmbushjen me sukses të detyrimeve kushtetuese për mbrojtjen e vendit, si dhe ndaj NATO-s.

Marrja e drejtimit të disa iniciativave rajonale gjatë vitit 2019 ka evidentuar qartë leadershipin e vendit tonë si faktor stabiliteti për mbrojtjen dhe sigurinë në rajon.

Realizmi i objektivave në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë, si një proces gjithëpërfshirës, kërkon dhe mirëpret kontributin e çdo anëtari të FA-së për t’u përballur me sfidat e reja, për t’iu përgjigjur detyrimeve që rrjedhin nga misioni kushtetues.

### **Për të gjithë ata që shërbejnë në Forcat e Armatosura.**

Gjatë vitit 2019, pjesëtarët e FA-së kanë shërbyer me profesionalizëm dhe përkushtim për përballimin e emergjencave civile dhe fatkeqësive natyrore, rritjen e sigurisë së qytetarëve tanë, si dhe për sigurinë dhe stabilitetin ndërkombëtar në misionet e NATO-s, BE-së dhe OKB-së. Përkushtimi dhe profesionalizmi i treguar në të gjitha angazhimet kanë rritur besueshmërinë dhe kanë fituar respektin e shoqërisë tonë dhe Aleancës ndaj FARSH-it.

Viti 2020 shtron përpara FA-së detyra dhe sfida të reja, të cilat do të kërkojnë më shumë angazhim, profesionalizëm dhe përkushtim nga të gjitha strukturat e FA-së.

## **I. DREJTIMET KRYESORE PËR VITIN 2020**

Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë do të zhvillojnë kapacitete të afta për të siguruar pavarësinë e vendit, mbrojtjen e tërësisë territoriale, ndihmën ndaj popullsisë civile, si dhe rendin kushtetues të vendit. Nisur nga këto përgjegjësi kushtetuese, veprimtaria e FARSH-it do të fokusohet në harmonizimin dhe përmbushjen e objektivave të përcaktuara në dokumentet strategjike, unifikimin dhe realizimin e procesit të planifikim-programimit, përmbushjen e detyrimeve të përcaktuara në paketën e Objektivave të Kapaciteteve (OK), vijimin e reformimit dhe konsolidimit të sistemit të arsimit në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë kombëtare, rritjen e nivelit të trajnimit të efektivëve, si dhe realizimin e kontributeve të deklaruara në operacione.

### **Drejtimit kryesore të punës gjatë vitit 2020 do të jenë:**

1. Mjedisi i sigurisë dhe përshtatja e vazhdueshme ndaj tij;
2. Përmirësimi i bazës ligjore;
3. Modernizimi, Zhvillimi i Kapaciteteve, Gatishmëria dhe Operacionaliteti, Ndërveprueshmëria;
4. Zhvillimi i burimeve të mbrojtjes;
5. Ngritja e një sistemi efektiv për menaxhimin e emergjencave civile dhe ndihma ndaj komunitetit;
6. Angazhimi dhe bashkëpunimi ndërkombëtar.

## **II. PRIORITETET KRYESORE TË PUNËS PËR VITIN 2020**

Veprimtaria e strukturave të MM-së dhe FA-së për vitin 2020 do të fokusohet në këto drejtime kryesore:

### **1. Mjedisi i sigurisë dhe përshtatja e vazhdueshme ndaj tij.**

Mjedisi ndërkombëtar i sigurisë vijon të bëhet më i paqëndrueshëm dhe më i paparashikueshëm. Burimet e stabilitetit në nivel global janë të shumta, karakteristike e të cilave mbetet përhapja e tyre me shpejtësi përtej kufijve të origjinës. Ky mjedis dinamik nxit ndjeshëm kërcënimet dhe rreziqet, të cilat do të vijnë të ndikojnë situatën e sigurisë rajonale dhe atë ndërkombëtare.

Vendi ynë është i ekspozuar ndaj rreziqeve, si: terrorizmi, ekstremizmi, aktivitetet jo-miqësore të shërbimeve të inteligjencës, kërcënimet kibernetike, hibride, konvencionale, si dhe emigracioni i paligjshëm dhe krimi i organizuar.

Nisur nga vlerësimi i mjedisit të sigurisë dhe evoluimin e tij, strukturat e MM-së dhe FA-së të marrin të gjitha masat e nevojshme, në bashkëpunim edhe me aleatët, për zbatimin e praktikave më të mira për parandalimin e të gjitha kërcënimeve të mundshme.

Gjatë vitit 2020 të fillojë puna për ngritjen e kapaciteteve të reja të zbulimit për të rritur mbështetjen me zbulim të FA-së dhe pajisjen e vendimmarrësve me informacionet e nevojshme për të mbështetur procesin e vendimmarrjes.

Siguria e personelit, informacionit, ajo fizike dhe industriale të vijnë të jenë prioritet për strukturat e FA-së gjatë planëzimit dhe zhvillimit të operacioneve brenda vendit, si dhe në kuadër të NATO-s, BE-së dhe OKB-së.

### **2. Përmirësimi i bazës ligjore.**

Do të vijojë puna për rishikimin e akteve ligjore e nënligjore, me qëllim përmirësimin e funksionimit të strukturave të MM/FA-së. Rëndësi e veçantë t'i kushtohet akteve ligjore e nënligjore në mbështetje të zbatimit të ligjit "Për mbrojtjen civile", për investimet në bazën e

Kuçovës, aktet ligjore që lidhen me gradat dhe karrierën e ushtarakut, disiplinën në FA, si dhe kuadrin ligjor në interes të përmirësimit të trajtimit me pagë, ushqim dhe veshmbathje të ushtarakëve.

Në kuadër të përafrimit me legjislacionin e Bashkimit Evropian, puna të fokusohet në miratimin e akteve ligjore dhe nënligjore të Planit Kombëtar për Integrimin Evropian 2019 – 2021, të cilat janë pjesë e fushës së përgjegjësisë të Ministrisë së Mbrojtjes.

### **3. Modernizimi, Zhvillimi i Kapaciteteve, Gatishmëria dhe Operacionaliteti, Ndërveprueshmëria.**

**3.1. Modernizimi** i FA-së të synojë sigurimin e kapaciteteve të nevojshme për të vepruar në mënyrë të pavarur dhe/ose në bashkëpunim me aleatët në operacione dhe misione ushtarake, si dhe në përballimin e emergjencave civile. Procesi i modernizimit të fokusohet në zhvillimin e kapaciteteve të FA-së, në përputhje me Planin Afatgjatë të Zhvillimit të FA-së, vijimin e projekteve të modernizimit, pajisjen e Forcave Tokësore me armatim të ri të ndërveprueshëm me aleatët, kompletimin e strukturave të kërkim-shpëtimit me pajisje speciale, investimet në infrastrukturë për përmirësimin e mjediseve të punës, modernizimin e pajisjeve dhe sistemeve kompjuterike.

**3.2. Zhvillimi i kapaciteteve** të synojë përmbushjen e detyrimeve kombëtare në kuadër të Paketës së Objektivave të Kapaciteteve (OK) 2017, duke zhvilluar kapacitetet e luftimit, mbështetjes me luftim dhe shërbime të luftimit.

Prioritet kryesorë në këtë drejtim do të jenë:

- Grup-Batalioni i Këmbëtorisë së Lehtë (GBKL), repartet dhe nënrepartet e deklaruara në kuadër të angazhimeve ndërkombëtare NATO, BE-së etj.;
- Ngritja e Njesisë Ushtarake të Sigurisë Kibernetike;
- Krijimi i kapaciteteve operacionale për vëzhgimin dhe monitorimin e hapësirës ajrore të RSH-së;
- Sigurimi i një Grupi Taktik të Kontrollit Ajror në interes të formacioneve tokësore të dislokueshme në nivel batalioni dhe/ose grup-batalioni.

### **3.3. Gatishmëria dhe Operacionaliteti.**

Të punohet për zhvillimin dhe mbajtjen në gatishmëri të kapaciteteve tokësore, detare, ajrore, si dhe mbështetjen logjistike në të gjitha nivelet e komandim-kontrollit (C2), për të zhvilluar operacione të mbrojtjes kombëtare dhe kolektive, për të reaguar me shpejtësi ndaj krizave të paparashikuara, përballimin e emergjencave civile/fatkeqësive natyrore.

Të synohet implementimi i plotë i masave të NATO-s në sistemin kombëtar në përgjigje të krizave, si dhe në planëzimin operacional të përdorimit të FARSH-it, përballë kërcënimeve asimetrike, hibride, por edhe atyre konvencionale.

Sigurimi i kapaciteteve operacionale dhe vijimi i angazhimeve operacionale të FA-së për pjesëmarrje në operacionet e ndryshme, si dhe testimi i gatishmërisë dhe operacionalitetit të tyre, të synojnë përmbushjen e kërkesave specifike të Aleancës për çdo mision. Gjatë vitit 2020, krahas angazhimit në misionet aktuale ndërkombëtare, të punohet për materializimin e angazhimit në nismën rajonale “ADRION” (Adriatic Ionian Initiative).

### **3.4.Ndërveprueshmëria.**

Do të punohet për rritjen e ndërveprueshmërisë në nivel kombëtar dhe me NATO-n, nëpërmjet ndërveprimit të komponentëve njerëzorë, pajisjeve dhe procedurave. Prioritet do të jetë vijimi i procesit të standardizimit, duke përzgjedhur për implementim STANAG/AP-të që mbështesin Objektivat e Kapaciteteve dhe prioritetet e FA-së.

### **4. Zhvillimi i burimeve të mbrojtjes.**

#### **4.1. Burimet njerëzore, rekrutimi, promovimi.**

Burimet njerëzore do të vijojnë të mbeten një ndër elementët kryesorë të burimeve të mbrojtjes. Zhvillimi i tyre do të synojë konsolidimin e sistemit të menaxhimit të tyre, zbatimin e një procesi transparent, të besueshëm dhe efektiv përgjatë gjithë ciklit jetësor të personelit: rekrutimin, arsimimin, trajnimin, emërimin në detyrë, promovimin në gradë dhe karrierë, daljen në rezervë dhe në pension.

Emërimi në detyrë të bëhet në përputhje me Tabelat e Organizimit dhe Pajisjeve të FA-së. Një prioritetet të veçantë të këtë plotësimi me personel cilësor i strukturave të deklaruara për angazhimet në NATO, si dhe në strukturat komanduese të saj.

Bashkëpunimi me institucionet qendrore dhe lokale, institucionet arsimore, marketingu profesional, bazuar në nevojat aktuale dhe të perspektivës, përvoja dhe eksperiencia e fituar, të vlerësohen si faktorë kryesorë për të rekrutuar në FA kandidatë me kapacitete të larta intelektuale dhe fizike, duke synuar freskimin me personel të ri dhe të përkushtuar.

Për motivimin e personelit të zhvillohen politika social-ekonomike, me synim përmirësimin e trajtimit dhe kushteve të jetesës, punës dhe shërbimit, rritjen e përkujdesjes ndaj familjeve të ushtarakëve, miradministrimin e mjediseve pushuese, krijimin e lehtësirave të tjera për personelin ushtarak dhe familjet e tyre, si dhe eksplorimin e të gjitha mundësive për integrimin e ushtarakëve në shoqëri, pas daljes në rezervë të tyre.

Të punohet për arritjen dhe ruajtjen e përfaqësimit me 15% të femrave në uniformë në rekrutim e promovim dhe prespektiva gjinore të jetë pjesë e politikave dhe planeve të strukturave të MM-së dhe SHPFA-së.

#### **4.2. Arsimimi, trajnimi dhe stërvitja.**

**Arsimimi** ushtarak do të vijojë të zhvillohet dhe të konsolidohet në përputhje me ligjin “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në RSH”, ligjin “Për pushtetet dhe autoritetet e drejtimit e të komandimit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë” dhe ligjin për gradat dhe karrierën, si dhe do të bazohet në konceptin e ri arsimor, trajnimin individual dhe kolektiv.

Të synohet përmirësimi rrënjësor i sistemit të arsimit ushtarak, me të gjitha elementet e nevojshme organizative dhe strukturore, konceptuale dhe doktrinare, si dhe të punohet për sigurimin e ndërveprueshmërisë me sistemet më të mira të arsimit e të kualifikimit ushtarak të vendeve të NATO-s.

Akademia e Forcave të Armatosura të arrijë kapacitetet e plota operationale, të marrë masat e nevojshme për plotësimin e kriterëve për akreditimin e të gjitha institucioneve të arsimit ushtarak, organizimin, drejtimin dhe menaxhimin e këtij institucioni.

Detyrë prioritare do të jetë përgatitja e oficerëve të rinj përmes kalimit në sistemin e arsimit 3-vjeçar, në përputhje me programin e ciklit të parë “Bachelor”. Të konsolidohen strukturat e kërkimit shkencor, eksperimentimit dhe simulimit në funksion të FA-së dhe institucioneve të tjera të mbrojtjes dhe sigurisë.

Në fushën e zhvillimit të doktrineve puna të fokusohet në përgatitjen e doktrinës logjistike, doktrinës së ndërlidhjes, direktivës së planëzimit operacional dhe stërvitjes, të cilat do të synojnë rritjen e cilësisë dhe profesionalizimit të personelit ushtarak dhe civil të strukturave të FA-së në të gjitha nivelet.

**Trajnimi** të përmbushë kërkesat që kanë strukturat e FA-së në të gjitha nivelet dhe nevojat sipas specialiteteve. Vëmendje e veçantë t'i kushtohet trajnimeve për mbështetjen e Objektivave të Kapaciteteve, përgatitjes së personelit dhe forcave që do të marrin pjesë në operacione jashtë vendit. Në kuadër të bashkëpunimit ndërkombëtar, fokusi të jetë realizimi i trajnimeve të personelit pilot, teknik/mirëmbajtës, kontrollor të trafikut ajror, operator radari, specialist dhe teknik të Sistemit të Integruar të Vëzhgimit të Hapësirës Ajrore.

**Stërvitja** të synojë aftësimin e personelit për planëzimin dhe zhvillimin e operacioneve në të gjitha nivelet e komandimit, në funksion të përmbushjes së misioneve dhe detyrave si në planin kombëtar dhe atë ndërkombëtar. Cikli stërvitor gjatë vitit 2020 të mundësojë përgatitjen, stërvitjen dhe vlerësimin operacional të strukturave sipas standardeve dhe metodologjisë së NATO-s. Prioritet gjatë vitit 2020 mbetet zhvillimi në vendin tonë i stërvitjes "Albanian Reaction 20".

Zhvillimi i stërvitjeve ndërinstitucionale të synojnë forcimin e koordinimit dhe bashkëpunimit ndërinstitucional në kuadër të zhvillimit të operacioneve në përgjigje të emergjencave civile, kërkim-shpëtimit dhe për reagimin ndaj ndotjeve detare.

#### **4.3. Burimet materiale.**

Burimet materiale do të synojnë sigurimin e kapaciteteve logjistike të nevojshme për mbështetjen e aktiviteteteve të përditshme të FA-së, si dhe pjesëmarrjen e tyre në operacionet brenda dhe jashtë vendit. Vëmendja të përqendrohet në sigurimin e kapaciteteve për mirëmbajtjen e mjeteve tokësore, zhvillimin e kapaciteteve fillestare riparuese dhe mirëmbajtjes së helikopterëve.

MM-ja dhe SHPFA-ja dhe strukturat e përfshira të mbështesin në mënyrë të veçantë zbatimin e projekteve të NATO-s, për modernizimin e Bazës Ajrore Kuçovë.

Zhvillimi i infrastrukturës të synojë përmirësimin e kushteteve për jetesë, edukim, stërvitje, mbështetje të operacioneve dhe komandim-kontrollit, ngritjen e rrjetit të transmetimit të të dhënave të Shërbimit Meteorologjik Ushtarak, ngritjen e Sektorit të Fotografisë në Institutin e Gjeografisë dhe Infrastrukturës Ushtarake, mirëmbajtjen dhe zhvillimin e Sistemeve të Teknologjisë dhe Informacionit, zbatimin e projekteve në infrastrukturë.

Të përqendrohen përpjekjet për riparimin, rindërtimin dhe rikthimin në normalitet të infrastrukturës së dëmtuar nga tërmeti i 26 nëntorit 2019.

Mbështetja shëndetësore të fokusohet në rritjen e përkujdesjes mjekësore ndaj personelit ushtarak dhe civil të FA-së, si dhe certifikimin e gjendjes shëndetësore të personelit ushtarak. Përparësi t'i kushtohet mbështetjes shëndetësore të reparteve prioritare dhe aftësimin të personelit mjekësor.

Trajtimi i pronave jashtë Planit të Përhapjes dhe Vendosi të FA-së, trajtimi i materialeve të tepërta, asgjësimi, demontimi/tjetërsimi i municioneve të tepërta dhe jashtë nevojave të FA-së do të realizohet bazuar në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi. Strukturat administruese të pronave të punojnë me prioritet për regjistrimin dhe pajisjen me certifikatë të çdo prone në administrim të tyre.

#### **4.4. Burimet financiare.**

Buxheti i mbrojtjes të synojë përmbushjen e detyrave të FA-së, brenda vendit, angazhimeve ndërkombëtare në kuadër të NATO-s, angazhimeve në kuadër rajonal dhe rritjen e aftësive trajnuese të FA-së.

Realizimi me efektivitet i buxhetit do të arrihet nëpërmjet përmirësimit të planifikimit të studiuar të strukturës buxhetore, bazuar në prioritetet e zhvillimit të FA-së, si dhe rritjes së transparencës gjatë menaxhimit të tij. Burimet financiare të mbështesin zhvillimin e kapaciteteve të FA-së, me synim rritjen e operacionalitetit dhe ndërveprueshmërisë me të gjitha strukturat, si në planin kombëtar, ashtu dhe në atë rajonal e më gjerë.

Disiplinimi me përgjegjshmëri i buxhetit vjetor, mbështetja e programeve të mbrojtjes, sinkronizimi në përcaktimin e prioriteteve, si dhe hartimi në kohë i projekteve duhet të jenë kushtet thelbësore, të cilat do të mundësojnë orientimin dhe përdorimin sa më me efektivitet të burimeve të mbrojtjes dhe realizimin në kohë e me cilësi të buxhetit.

#### **5. Ngritja e një sistemi efektiv për menaxhimin e emergjencave civile dhe ndihma ndaj komunitetit.**

Miratimi i ligjit “Për mbrojtjen civile” ishte një zhvillim domethënës në reformimin e gjithë procesit të qasjes dhe të menaxhimit të emergjencave civile. Tërmeti i 26 nëntorit 2019 testoi realisht funksionalitetin e strukturave planëzuese, koordinuese, si dhe kapacitetet operationale reaguese dhe mbështetëse.

Prioritet i veçantë për vitin 2020 të jetë përfundimi i hartimit të akteve nënligjore për funksionimin e plotë të Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile (AKMC), si dhe përmirësimin, modernizimin dhe ngritjen e strukturave dhe kapaciteteve operationale reaguese për përballimin e emergjencave civile, bazuar në nevojat tona, eksperiencën e vendeve të tjera, si dhe mësimet e nxjerra.

Mbështetja dhe ndihma ndaj komunitetit do të fokusohet në mbrojtjen e jetës së njerëzve, pronës, trashëgiminë kulturore dhe mjedisit, mbështetje të komunitetit në veçanti në zonat e largëta. Do të koordinojmë dhe mbështesim marrjen e përgjegjësive nga strukturat e përfshira në përballjen me emergjencat civile, në përputhje me detyrimet e përcaktuara në ligjin “Për mbrojtjen civile”.

Do të vlerësohen me seriozitet kërkesat dhe nevojat e njësive të qeverisjes vendore për eliminimin e rreziqeve potenciale në zonat e tyre, si dhe për përmirësimin e infrastrukturës. Brenda vitit 2020 do të përfundojë pastrimi i hotspotit Jub-Sukth, Durrës.

Planifikimi i rezervave të nevojshme materiale të synojë përmirësimin e kuadrit ligjor për përdorimin e burimeve kombëtare dhe ndërkombëtare, rritjen e kapaciteteve transportuese, vijimin e plotësisht të gjendjes së mallrave, sipas kërkesave ligjore në fuqi, shtimin dhe përmirësimin e kapaciteteve magazinuese, me qëllim realizimin e ndihmës ndaj popullatës së prekur nga fatkeqësitë e ndryshme natyrore në çdo kohë dhe nevojë.

#### **6. Angazhimi dhe bashkëpunimi ndërkombëtar.**

##### **6.1. Bashkëpunimi ndërkombëtar.**

Angazhimi ndërkombëtar dhe bashkëpunimi me vendet partnere në fushën e mbrojtjes të jetës në harmoni të plotë me interesat kombëtare dhe strategjike të sigurisë së Republikës së Shqipërisë dhe të bazohet në ndërtimin e marrëdhënieve të karakterizuara nga fryma e mirëkuptimit dhe bashkëpunimit, si dhe të mbështesë proceset integruese të vendit tonë në Bashkimin Evropian.

Në kuadër të angazhimit me Aleancën, takimi i ministrave të Mbrojtjes të vendeve NATO-s, që do të mbahet në qershor 2020 në Tiranë, të jetë prioriteti kryesor i punës së strukturave të MM/FARSH-it. Do të përshpejtohet ndërveprimi me NATO-n, për përmbushjen e detyrimeve të Paketës së Objektivave të Kapaciteteve.

Të punohet për përafrimin e legjislacionit shqiptar me atë të BE-së në fushën e sigurisë dhe mbrojtjes dhe të orientohemi drejt nismave të ndryshme të mbrojtjes në kuadër të Politikës së Përbashkët të Sigurisë dhe Mbrojtjes.

### **6.2 Bashkëpunimi rajonal.**

Të ndërmerren iniciativa për rritjen e bashkëpunimit në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë, me qëllim zhvillimin e aftësive dhe kapaciteteve rajonale të mbrojtjes dhe qëndrueshmërisë (mbrojtjes civile), si dhe integrimin e plotë të vendeve të rajonit në institucionet euroatlantike.

Në iniciativat rajonale në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë të vijohet promovimi i “politikës së dyerve të hapura” për vendet e tjera të rajonit (në veçanti Kosovës), të cilat aspirojnë të jenë pjesë e këtyre forumeve, si mënyra më e mirë në funksion të nxitjes më tej të marrëdhënieve të fqinjësisë së mirë, rritjes së bashkëpunimit midis vendeve dhe për përbashkimin e sfidave të përbashkëta të sigurisë.

Kryesimi i Sekretariatit të SEDM-it dhe përmbushja e detyrimeve gjatë vitit 2020 të jenë prioriteti kryesor në fushën e bashkëpunimit rajonal. Të punohet për materializimin e përfaqësimit të përbashkët të vendeve të A-5 në misionin e NATO-s në Irak.

### **6.3 Kontributi në operacionet dhe iniciativat ndërkombëtare.**

Përmbushja e të gjitha angazhimeve operacionale, në përputhje me tri detyrat thelbësore të Aleancës: Mbrojtja Kolektive, Menaxhimi i Krizave dhe Siguria Bashkëpunuese, të shprehura në Konceptin Strategjik të saj, të jenë fokusi kryesor i punës në këtë drejtim.

Të vijojë kontributi për sigurinë kolektive dhe pjesëmarrja aktive në operacione, misione dhe iniciativa në kuadër të NATO-s, BE-së, OKB-së dhe koalicioneve të vullnetit, në veçanti në luftën kundër terrorizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm, duke synuar një rol promovues, aktiv, kontribues për konsolidimin e sigurisë, stabilitetit dhe paqes në rajon dhe në botë.

## **III. PËRFUNDIME**

Direktiva e Mbrojtjes 2020 do të orientojë gjithë veprimtarinë e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë në përmbushjen e misionit dhe të detyrave të saj.

Për zbatimin e Direktivës së Mbrojtjes 2020, të gjitha strukturat e MM/FARSH-it të hartojnë plane dhe koordinojnë përpjekjet për të siguruar aftësitë e nevojshme për mbrojtjen, sigurinë dhe prosperitetin e vendit tonë.

**MINISTRI**

**Olta Xhaçka**